



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1084_01_14**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 10.04.2014.

në seancën e mbajtur më datë 29 prill 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin M. K. me shifër të konsumatorit: DPR – 90041273) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1106_03_14 i datës 18.03.2014.

Arsyetim

Me datë 11.02.2009 konsumatori sipas rregullave dhe procedurave në fuqi ka parashtruar kërkesën në KEK për lidhje të re.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 01.04.2009 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë bërë pranimin teknik për njehsorin elektrik nr. 3721742 me gjendje të shpenzimeve të regjistruara TL=002528 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=009461 kWh (tarifa e ulët) dhe kanë theksuar ribllombim.

Departamenti i Faturimit në KEDS me datë 04.06.2013 e ka faturuar konsumatorin me shërbime për lidhje të re në vlerë **116.00€**.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEDS-it me datë 06.06.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kundërshtuar faturimin për shërbimet lidhje e re. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 18.03.2014 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS që: 1) Të shkarkon konsumatorin me shifër DPR – 90041273 nga fatura nr. 705-DPR13S152461 e datë 04.06.2013 për shërbime/lidhje e re në vlerë **116.00€**.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës për faktin se në bazë të shënimeve që disponon KEDS një numër i konsumatorëve ka qenë i kyçur në rrjetin energjetik dhe janë faturuar si



konsumator ilegal, edhe pse ka bërë kërkesë në muajin janar dhe shkurt 2009 konsumatori në fjalë nuk është trajtuar si konsumator i ri, pasi që i njëjti ka shfrytëzuar energji nga viti 2006. Pas kësaj në vitin 2013 të gjithë konsumatorët ilegal janë ftuar nga shfrytëzuesi që të paraqitën në sportelet përkatëse për nënshkrim të kontratave në mënyrë që të legalizohen. Pika 2 e kundërshtimit është për faktin se KEDS-i nuk është obliguar që konsumatorin ta liroi nga pagesa, pasi që e njëjta nuk ka të bëjë me urdhëresën e datës 19.12.2008, e cila vazhdohet deri me datën 30.01.2009.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29 prill 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e KEDS nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka bërë gabimisht vlerësimin e provave gjatë vendosjes së kësaj çështje. Nga ajo që shihet në shkresat e lëndës vërehet se KEK ka faturuar konsumatorin nga viti 2006 e deri në vitin 2009 si konsumator ilegal dhe është faturuar me rregull. Bordi i ZRRE-së lidhur me këtë ka konstatuar se KEK nuk ka marr veprimet e nevojshme ligjore për të bërë regjistrimin e rregullt të këtij konsumatori, e jo të pritët për 3 vite me radhë dhe të mos merret një veprim i tillë.

Sa i përket pikës 2 të kundërshtimit, se KEDS-i nuk është obliguar që konsumatorin ta liroi nga pagesa, pasi që e njëjta nuk ka të bëjë me urdhëresën e datës 19.12.2008, e cila vazhdohet deri me datën 30.01.2009. Bordi i ZRRE-së pas analizimit dhe vlerësimit të kësaj pike dhe shkresave tjera të lëndës ka vërejtur se, nga vet zyrtarët e KEDS është konfirmuar përmes shkresës elektronike të datës 02.02.2009 me të cilën vërtetohet se periudha e parashtrimit të kërkesës për legalizimin e kyçjeve ilegale nga ana e konsumatorëve është shtyrë nga ana e KEK sha edhe për një muaj përkatësisht deri me datë 28.02.2009. Në anën tjetër konsumatori me datë 11.02.2009 ka bërë kërkesë në KEK për lidhje të re, mirëpo një kërkesë e tillë i është refuzuar nga ana e KEK. Mbi bazën e gjithë kësaj Bordi ZRRE-së, konstaton se KEK, ka vepruar në kundërshtim me Urdhëresën ekzekutive nr. 51 e datës 19.02.2008 dhe shkresën elektronike e datës 02.02.2009 ku thuhet se shtyhet afati edhe për një muaj që nënkupton se konsumatori duhet të përfshihet në listën e të liruarve nga pagesa për shërbime për lidhje të re.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEDS në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1106_03_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar